

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                              |
|---------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Nga një milici lokale, në forcë të armatosur me raketa/ Pse huthit janë bërë kaq të rrezikshëm?              |
| ADRESA  | https://piranjat.al/bota/nga-nje-milici-lokale-ne-force-te-armatosur-me-raketa-pse-huthit-jane-bere--i106090 |
| BURIMI  | piranjat.al                                                                                                  |
| GJENDJA | online                                                                                                       |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 25 shtator 2026, 17:43:20 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 17:30:31 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 3f8f9ec6a05eb19ffbe85ad7e7d1ac602505640d2c8ff96b4a0fef9d8bb873be |
| TEKSTI     | f72e30ae1362583176ebf73814b07dbc5179c4d2298ba873ce227ae5eaddf90a |
| PAMJA      | 233cc1ec2c42ddb45aafc0c6840949f560c27ccd2b20d8a7febbaa46d9e76b9a |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | d34e0874fec426b46944457ecaede805c5d6ca2fbf03529fe97c7b1fb20d78cf                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | b795f32e8dcdad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d34e0874fec426b46944457ecaede805c5d6ca2fbf03529fe97c7b1fb20d78cf>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [nndaluar për të rinjtë](#) së PD-së, ku ka folur për situa... ■ [anetari i ri i KLGJ-së](#) së Lartë, për anëtar të Këshillit ■ [te shpëllim të Komisarariatit të Krujës,](#) parë me qytetin e Durrësit, ku shefi i ■ [me emocionon dhe më](#) mënyrën se si do ta ndërtojë skuadrë ■ [teserituar kredenciale te](#) në Tiranë, ndërsa nesër pritët

[BOTA](#)

## Nga një milici lokale, në forcë të armatosur me raketa/ Pse huthit janë bërë kaq të rrezikshëm?

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 19:30



Përballë Arabisë Saudite, që vetëm në vitin 2025 shpenzoi rreth 83 miliardë dollarë për mbrojtjen dhe zotëron ndër armët më të sofistikuar amerikane, qëndrojnë Huthët, një forcë që në pamje të parë duket shumë më e dobët.

Ata nuk kanë avionin, i nënshtrohen prej vitit 2015 embargos së armëve nga OKB-ja dhe kanë përballuar për vite bllokadën ajrore e detare të vendosur nga Riadi.

Megjithatë, pavarësisht kësaj pabarazie, huthinjtë vazhdojnë të kontrollojnë zona të rëndësishme të Jemenit dhe kanë zgjeruar ndjeshëm aftësitë e tyre ushtarake.

Në fillim të shtatorit, ata ndërmorën një ofensivë të re përgjatë bregdetit të Detit të Kuq, duke marrë portin e Mokhas, qytetin e Dhubabit dhe ishujt Zuqar e Perim. Kjo u jep atyre një pozicion të rëndësishëm pranë ngushticës Bab el-Mandeb, një nga korridoret kryesore të tregtisë botërore.

Më 19 shtator, për herë të parë, sulmet e tyre prekën edhe rrethinat e Riadit. Huthinjtë pretenduan se kishin goditur "objekte të ndjeshme" në kryeqytetin saudit dhe instalime të kompanisë së naftës Aramco në Yanbu.

Koalicioni i udhëhequr nga Arabia Saudite konfirmoi se kishte interceptuar një raketë të lëshuar nga Jemeni. Ky zhvillim tregon se huthët nuk janë më milicia e kufizuar që ishin në fillim të luftës civile, në vitin 2014, kur numëronin rreth 30 mijë luftëtarë.

Sipas një raporti të ekspertëve të OKB-së, në fund të vitit 2024 ata ishin shndërruar nga një grup lokal me kapacitete të kufizuara në një organizatë ushtarake të fuqishme, me aftësi që shtrihen shumë përtej territoreve nën kontrollin e tyre.

Në këtë transformim, roli i Iranit ka qenë vendimtar. Teherani ka ndihmuar në trajnimin e huthinjve përmes Gardës Revolucionare, Hezbollahut dhe milicive irakiane, ndërsa hetimet ndërkombëtare kanë evidentuar furnizime me komponentë dhe teknologji për prodhimin e dronëve dhe raketave.

Në qershor 2025, organizata britanike Conflict Armament Research identifikoi më shumë se 800 komponentë, përfshirë antena, mikroprocesorë dhe sisteme navigimi, në një ngarkesë të sekuestruar dhe të lidhur me rrjete furnizimi iraniane.

Aktualisht arsenali i huthinjve përfshin raketa balistike me rreze që mund të arrijë Izraelin, si dhe lloje të ndryshme dronësh të përdorur kundër anijeve në Detin e Kuq. Për më tepër, ata kanë fituar përvojë të konsiderueshme luftarake.

Pavarësisht bombardimeve saudite dhe sulmeve amerikane gjatë vitit 2025, huthinjtë kanë ruajtur kontrollin e kryeqytetit Sana dhe të një pjese të konsiderueshme të vendit. Dobësia e forcave qeveritare ka luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm.

Fronti anti-Huthi është i fragmentuar dhe Këshilli Drejtues Presidencial nuk ka arritur të koordinojë në mënyrë efektive grupet rivale. Tërheqja e trupave të Emirateve të Bashkuara Arabe nga Jemeni në fund të vitit 2025 e dobësoi më tej këtë front.

Reformat e mëvonshme të ushtrisë, të ndërmarrura nga Arabia Saudite për të eliminuar edhe fenomenin e "ushtarëve fantazmë", nuk kanë mjaftuar. Rasti i Mokhas është domethënës.

Më 10 shtator, forcat që duhej të mbronin portin, të drejtuara nga Tareq Saleh, u tërhoqën përpara avancimit të huthinjve, duke ua lënë qytetin pothuajse pa rezistencë.

Për Arabinë Saudite, kjo krijon një dilemë të vështirë. Sulmet e huthinjve mund të justifikonin një rikthim në një luftë të gjerë, por një ndërhyrje e re në Jemen do të kishte kosto të lartë ushtarake, politike dhe sigurie për territorin saudit.

Sipas studiuesit Laurent Bonnefoy, Riadi dëshironte të tërhiqej pikërisht për të shmangur këtë skenar. Edhe mbështetja e jashtme mbetet e kufizuar.

Reuters raporton se në mesin e shtatorit përfaqësues amerikanë u takuan me drejtues të Huthëve në ambasadën amerikane në Muskat, ndërsa grupi u tha se kishte në shënjestër kryesisht sistemat saudite dhe jo anijet amerikane.

Ndërkohë, Pakistani dhe Turqia, pavarësisht marrëveshjeve të reja të sigurisë me Riadin, nuk kanë dhënë sinjale për një ndërhyrje të drejtpërdrejtë ushtarake. Kështu, një konflikt që dikur dukej si përballje mes një fuqie rajonale dhe një milicie të armatosur dobët ka marrë një tjetër dimension.

Huthinjtë janë shndërruar në një aktor ushtarak me raketa, dronë, përvojë luftarake dhe lidhje të qëndrueshme me Iranin, ndërsa Arabia Saudite po përballlet me pasojat e një lufte nga e cila kishte shpresuar të largohet.

## Artikuj te sugjeruar

BOTA 25 Shtator18:35

### [Parashikimi i tmerrshëm i Bill Gates: Inteligjenca artificiale mund të shkaktojë vdekjen e një miliard njerëzve](#)

Bill Gates bëri një deklaratë tronditëse, duke vlerësuar se inteligjenca artificiale mund të shkaktojë vdekjen e një mil...

BOTA 25 Shtator18:08

### [Tensione në qiell/ Avionët e Suedisë dhe Finlandës "lojëra lufte" me avionët e Rusisë](#)

Forcat ajrore finlandeze thanë të premtën se avionë luftarakë suedezë dhe finlandezë ishin ngritur në ajër për t&eu...

BOTA 25 Shtator17:00

### [Melania Trump kritikohet për paraqitjen e saj në takimin mes Xi Jinping dhe Donald Trump: Duket si kameriere! A nuk do të ishte një fustan më i përshtatshëm?](#)

Melania Trump u përball me kritika të shumta pas takimit të Donald Trump me presidentin kinez Xi Jinping të enjten në Shtëpinë...

BOTA 25 Shtator15:15

### [“Raportet tona, kurrë më të mira”, Trump i dhuron Xi Jinping një shqiponjë të SHBA-së](#)

Një banket madhështor u shtrua në Shtëpinë e Bardhë në nder të presidentit kinez Xi Jinping. Të dy liderët s...

BOTA 25 Shtator15:00

### [Raporti i CIA-s për sulmet ruse, Macron: Nuk jemi informuar...](#)

Presidenti francez Emmanuel Macron ka mohuar raportimet se CIA kishte paralajmëruar Francën për një operacion të mundshëm rus me...

BOTA 25 Shtator14:46

### [Inteligjenca Artificiale hyn në tregun imobiliar, shtëpitë nuk duken më si në realitet](#)

Fotot perfekte të shtëpive që dalin në shitje online nuk janë gjithmonë reale. Inteligjenca artificiale po përdoret gjithnj...

BOTA 25 Shtator14:12

### [Nju Jorku padit Polymarket, akuzohet për shkelje të ligjeve të lojërave të fatit](#)

Nju Jorku ka ngritur padi ndaj platformës së tregjeve të parashikimit Polymarket, duke e akuzuar për operimin e lojërave të fati...

BOTA 25 Shtator13:53

### [Papa Leo XIV nis vizitën e parë zyrtare në Francë pas 18 vitesh](#)

Papa Leo XIV ka nisur vizitën e tij të parë zyrtare papnore në Francë, 18 vjet pas vizitës së fundit të këtij llo...

Piranjat News BOTA 25 Shtator13:19

### [Polemika politike në Itali për mungesën e Melonit në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së](#)

Vendimi i kryeministres Giorgia Meloni për të mos udhëtuar në Nju Jork për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së &eu...

BOTA 25 Shtator13:14

### [Zelensky: Trump ka marrë vendimin përfundimtar të na japë licencë për raketat Patriot](#)

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha sot se Presidenti i SHBA-së Donald Trump e informoi atë se do t'i jepte Ukrainës një lice...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 25 Shtator

### [“Më quajti lopë kur isha shtatzënë”/ Pas videos...](#)

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Kom...

AKTUALITET 24 Shtator

### [EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...](#)

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

AKTUALITET 24 Shtator

### [Sherr mes Lalës dhe Rexhajt: Meriton të rrihesh...](#)

Një përplasje e ashpër ka ndodhur në studion e "Opinion" mes analistit Albatros Rexhaj dhe gazetares Klodiana Lala. Debatu u nd...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

### [EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnamit ofrojnë shërbime sek\\*uale për 50-150 euro](#)

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...


## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





**Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.